

REPUBLIKË E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
21.11.2023			
01		Nr. Prot. Br. Prot. Prof. Nr.	Nr. Detyrës Br. Stranica No. Pages
		2139	4

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



Kolegji AAB



INSTITUTI AAB
PËR KONTABILISTË DHE AUDITORË TË CERTIFIKUAR

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Zyrës Kombëtare të Auditimit

dhe

Kolegjit AAB – Fakulteti Ekonomik,

Institutit AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar

Duke u nisur nga interesi i përbashkët për avancimin e cilësisë së mësimdhënies, e-të shërbimeve arsimore në Kosovë, dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e kontabilitetit, raportimit financiar, auditimit e fushave të ngjashme. Bazuar në dëshirën për përparimin e shkëmbimeve arsimore e profesionale në të mirë të rritjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore, trajnuese dhe institucionit më të lartë të kontrollit ekonomik e financiar në Kosovë. Me qëllim të përbashkët të krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit në dobi të studentëve të AAB-së, anëtarëve të Institutit AAB për Kontabilist dhe Auditor të Certifikuar dhe zyratëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ku palët i përfaqësojnë:

1. Zyra Kombëtare e Auditimit, përfaqësuar nga Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca;
2. Kolegji AAB Fakulteti Ekonomik, përfaqësuar nga Dekani, Medain Hashani;
3. Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Ylber Prekazi, (në tekstin e mëtejme: Palët); pajtohen të lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI sipas dispozitave në vijim:

Neni 1

Bashkëpunimi përfshinë por nuk kufizohet në:

- Promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet të aktiviteteve të përbashkëta;
- Hartimin e programeve për përgatitje dhe formim profesional të kandidatëve për nevojat e ZKA-së më qëllimi rritjen e kapaciteteve profesionale e arsimore;
- Organizimin e ligjëratave, trajnimeve dhe kryerjen e ekzaminimit të kandidatëve për kualifikim profesional që qojnë në marrjen e certifikatës për teknik kontabiliteti, kontabilist i certifikuar, auditor i certifikuar dhe programeve tjera në të ardhmen;
- Kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB, të Fakultetit Ekonomik në Zyrën Kombëtare të Auditimit, sipas kërkesave specifike që i kërkon ZKA-ja;
- Organizimin dhe të kryerjen e formave të ndryshme të edukimit të vazhdueshëm të kualifikimit profesional të zyrtarëve të ZKA-së;
- Organizimin / vijimin e kurseve të veçanta të organizuara nga AAB-ja, dhe të mbështetura nga ZKA-ja me stafin profesional, përfshirë lehtësimin e përgatitjeve për studime të studentëve;
- Shkëmbimin e vizitave të organizuara tematike në dy drejtime nga studentët dhe mësimdhënësit dhe stafit të ZKA-së në Kolegjin AAB;
- Bashkëpunim dhe fushata tematike ndër-institucionale për të mirën e përgjithshme si: rëndësinë e auditimit, procesin e auditimit, llojet e auditimit, rolin e ZKA-së në Kosovë dhe shënimin e ditëve të ndryshme ndërkombëtare e kombëtare;
- Lehtësimi i implementimit të hulumtimeve e studimeve të ndryshme me rëndësi shoqërore, relevante;
- Krijimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë së auditimit për veprimtarinë profesionale të anëtarëve të tij, në përputhje më kërkesat KKRf-së; FNK-së, INTOSAI, EUROSAI, etj.
- Organizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në fushën e kontrollit dhe raportimit financiar, kontabilitetit, analizave financiare dhe fusha të tjera të ngjashme;
- Konkurrimi i përbashkët në konkurse të ndryshme për projekte arsimore e hulumtuese në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- Organizimin e përbashkët dhe pjesëmarrjen në seminare, punëtori zhvillimore, e të tjera të karakterit kombëtar e rajonal në fushat e interesit të përbashkët.

INSTITUTI KOSOVAR PËR AUDITIMIN
KOMBËTAR E AUDITIMIT
KLANIJA REVIZUE / INKUBIM

NR. 100
Klanje, 10000
Klanje, 10000
Klanje, 10000

Neni 2

Kjo Marrëveshje e bashkëpunimit krijon parakushtet dhe kornizat për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet palëve dhe mund të nënkuptojë nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera specifike për jetësimin e bashkëpunimit konkret në suaza të pikave të caktuara më lartë, si për shembull në realizimi i punës praktike ose të ndërtimit të kapaciteteve.

Neni 3

Ekipet përkatëse nga të tri institucionet do të angazhohen në konsultime përgatitore dhe do të takohen për të operacionalizuar aktivitete të ndryshme të përbashkëta.

Neni 4

Marrëveshja nënshkruhet për kohë të pacaktuar. Menaxhmentet e palëve nënshkruese do të takohen rregullisht për të shqyrtuar jetësimin e saj në bazë vjetore. Për koordinimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve palët do të emërojnë nga një koordinator.

Neni 5

Palët mund të modifikojnë segmente të caktuara të bashkëpunimit me pajtim të ndërsjellë në një letër anësore për bashkëpunimin. Për jetësimin e bashkëpunimit në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional të personelit auditues të ZKA-së mund të lidhet marrëveshje e veçantë dypalëshe në kuptim të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Marrëveshja mund të përfundohet nga secila palë me një paralajmërim me shkrim së paku tre muaj para ndërprerjes së njëanshme. Pala mund të japë arsyet e ndërprerjes së bashkëpunimit në shkresën e paralajmërimit.

Neni 7

Marrëveshja nënshkruhet në tri (3) kopje në gjuhën shqipe, ashtu që secila palë mban nga një kopje të marrëveshjes në origjinal.

Neni 8

Mospajtimet ose interpretime eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Prishtinë, 21 nëntor 2023



Zyra Kombëtare e Auditimit



Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Kolegji AAB



Medain Hashani
Dekan i Fakultetit Ekonomik

Instituti AAB
për Kontabilist
dhe Auditor të Certifikuar



Ylber Prekazi
Drejtor Ekzekutiv

